

**Zurijeta SALIU**  
**GABIMET DREJTSHKRIMORE DHE GRAMATIKORE NË DISA**  
**PORTALE**

UDC 81'271:004.773.6/.7

**Abstrakti:** Në të gjitha fushat gjuha kryen veprimin kryesor. Mirëpo e rëndësishmja është se si përdoret ajo. Me zhvillimin e teknologjive komunikative përdorimi i gjuhës ka pësuar edhe devijime. Duke i lënë anash bisedat e lira on-line në rrjetet e ndryshme sociale ku gjuha përdoret në mënyra dhe forma të ndryshme, gjuha poashtu nuk përdoret ashtu si duhet edhe nëpër media dhe portale të ndryshme. Edhe në këto fusha ku duhet të kemi një gjuhë të pastër dhe standarde hasim gabime drejtshkrimore, gramatikore, teknike etj.

Në këtë punim rëndësi të veçantë do të kenë gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore në portalet on-line "Almakos" dhe "Lajmpress".

Gabimet që janë hasur në këto portale janë:

- mungesa e shkronjës "ë" dhe "ç" (mungesa e këtyre dy shkronjave vjen si pasojë e shpejtësisë së shkruar, për arsye se këto dy shkronja mungojnë në tastier dhe është paksa më veshitirë për tu shkruajtur dhe zëvendësohen me shkronjën "e" dhe "c");

- mungesa e shkronjës së madhe (p.sh. komuna e Sarajit, ministri i Arsimit etj.);

- gabime gramatikore (mospërshtatja e fjalëve (p.sh. "qoftë që jetojnë Kroacia apo vendet tjera" në vend që të shkruhet "qoftë që jetojnë në Kroaci apo vende tjera" etj.).

Gjatë këtij hulumtimi do ti shohim edhe shumë gabime tjera dhe fjalë që nuk i përkasin gjuhës standarde.

**Fjalët kyçe:** gjuha, gabime, mungesa, shkronja, portale.

**Abstract:** Abstract: In all areas the language performs the main action, but the important thing is how it is used. With the development of modern communication technologies the use of language has also undergone deviations. Leaving aside free online conversations on different social networks where language is used in different ways and forms, language is also not used properly in different media and portals. Even in these areas where we need to have a clear and standard language, we encounter spelling, grammar and technical errors.

In this paper special significance will be spelling and grammar errors in online portals "Almakos" and "Lajmpress". Errors encountered in these portals during our research are:

- the absence of the letters "ë" and "ç" (the absence of these two letters is due to the speed of writing, because these two letters are missing on the keyboard and are slightly more difficult to write and are replaced by the letter "e" and "c").

- absence of capital letters (example: komuna e Sarajit, ministri i Arsimit etc.);

- lack of punctuation marks;

- grammatical mistakes (non-adaptation of words (example: "qoftë që jetojnë Kroacia apo vendet tjera" instead of writing whether qoftë që jetojnë në Kroaci apo vende tjera etc).

During this research we will see many other errors and words that do not belong to the standard language.

**Key words:** language, mistakes, shortages, letters, portals.

## Hyrje

Gjuha është element kryesor për komunikim, mirëpo ajo përdoret në mënyra të dhe forma të ndryshme.

Në këtë punim do të shohim se gjuha ndryshon edhe nga njerëz të një populli, të një vendi, d.m.th. secili individ ka mënyrën e vet të të shprehurit. Punimi në fjalë ka të bëjë me gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore të gjuhës, rëndësi të veçantë do të kenë gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore në portalet on-line “Almakos” dhe “Lajmpress”.

Gabimet që janë hasur në këto portale janë:

- mungesa e shkronjës “ë” dhe “ç” (mungesa e këtyre dy shkronjave vjen si pasojë e shpejtësisë së shkruar, për arsye se këto dy shkronja mungojnë në tastier dhe është paksa më veshtirë për tu shkruajtur dhe zëvendësohen me shkronjën “e” dhe “c”);

- mungesa e shkronjës së madhe (p.sh. komuna e Sarajit, ministri i Arsimit etj.);

- gabime gramatikore (mospërshtatja e fjalëve (p.sh. “qoftë që jetojnë Kroacia apo vendet tjera” në vend që të shkruhet qoftë që jetojnë në Kroaci apo vende tjera etj.).

Gjatë këtij hulumtimi do ti shohim edhe shumë gabime tjera dhe fjalë që nuk i përkasin gjuhës standarde.

## Mungesa e shkronjës “ë” dhe “ç”

*Duke qenë të vetëdijshëm se gati gjithkund hasim mungesën e këtyre dy shkronja, kjo problematikë shfaqet edhe nëpër portale e gazeta. Në portalet online “Lajmpress” dhe “Almakos” kemi një mungesë të madhe të shkronjave “ë” dhe “ç”.*

Kjo nuk do të thotë se gazetarët dhe shqipshkruesit nuk e dinë drejtshkrimin, mirëpo mospërdorimi i këtyre dy shkronjave është si pasojë e mungesës së shkronjave duke filluar nga tastiera, pastaj mungesa e gjuhës shqipe nëpër celularë dhe shumë më lehtë është të shkruhet shkronja “e” dhe “c”, të cila vetëm duhet të shtypen, se sa shkronja “ë” dhe “ç” që shkruhen në këtë mënyrë: shtypet butoni - *Alt dhe numrat - 0137* që të dale shkronja “ë” dhe për shkronjën “ç” duhet të shtypet butoni - *Alt dhe numrat - 0203*, gjë që është një punë pak e lodhshme dhe shumë më lehtë është që këto dy shkronja të zëvendësohen.

*Kështu që në këtë punim kemi analizuar disa lajme nga portalet e lartëpërmendura që u mungojnë këto shkronja:*

*Disa fjalë ku shkronja “ë” është zëvendësuar me shkronjën “e”:*

- baze – bazë;
- cilen – cilën;
- e qete – e qetë;
- eshte – është;
- jene – jenë;
- kete – këtë;
- kater – katër;
- kane – kanë;
- keshtu – kështu;
- mungese – mungesë;
- pjese – pjesë;
- perskaj – përskaj;

- *pervojes – përvojës;*
- *per – për;*
- *qytetaret – qytetarët;*
- *vetebesim- vetëbesim etj.*

*Disa fjalë ku shkronja “ç” është zëvendësuar me shkronjën “c”:*

- *cdokush – çdokush;*
- *cdo – çdo;*
- *cka – çka;*
- *corientim – çorientim;*
- *dicka – diçka etj.*
- *pervec – përveç;*
- *sic – siç;*
- *vecante – veçantë;*
- *vecanerisht – veçanërisht;*

*Një shembull konkret ku kemi mungesën e shkronjës “ë”;*

“pasi **ne kete** aksident janë plagosur dy **police** nga dy persona me prejarrdhje nga Kosova. **Per** shkak **te lendimeve te** njejtin është dashur të shtrohen në spital.” (24 shtator 2018, Lajmpress).

Në këtë lajm dikund kemi shkronjën “ë” e në disa fjalë na mungon ajo.

*Disa fjalë e humbin bukurshqiptimin, por ndonjëherë duke i lexuar ashtu si shkruhen ato e humbin edhe kuptimin.*

*p.sh. “police” në vend të fjalës “policë” (“police” – mendohet për gjininë femërore, ndërsa “policë” e kemi në numrin shumës për gjininë mashkullore).*

Rreth orës 21.15, te shtunen mbrena qendra e thirrjeve emergjente kantonale në Aarau ka pranuar një alarm, sipas të cilit në Buchs është shkaktuar një mosmarrëveshje për një veturë të parkuar gabimisht, ku janë përfshirë disa njerëz shkruajnë mediat zvicerane, përcjell fjala.ch..

Prokuroria ka filluar hetimet, pasi ne kete aksident janë plagosur dy police nga dy persona me prejarrdhje nga Kosova. Per shkak te lendimeve te njejtin është dashur të shtrohen në spital.

*Fotografia nr. 1*

### **Mungesa e shkronjës së madhe**

*Në portalet online te disa lajme hasim një numër të madh të institucioneve që fillojnë me shkronjë të vogël, edhe pse institucionet bëjnë pjesë në emrat e përveçëm. Emrat e përveçëm shkruhen gjithmonë me shkronjë të madhe.*

*Me shkronja të mëdha shkruhen emërtimet zyrtare (të sotme ose historike), emërtimet e institucioneve të shtetit, të organizatave shoqërore dhe të njëjësive ushtarake kryesore. (Drejtshtkrimi i Gjuhës Shqipe, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1974).*

disa shembuj ku emrat e institucioneve janë me shkronja të vogla:

- komuna e Sarajit – Komuna e Sarajit;
- komuna e Bogovinës – Komuna e Bogovinës;
- komuna e Likovës – Komuna e Likovës;
- ministria e Drejtësisë – Ministria e Drejtësisë;
- këshilli i Prindërve – Këshilli i Prindërve;
- kryetar i Këshillit – Kryetar i Këshillit etj.

Shembuj konkretë:

- “është zgjedhur për u.d kryetare e **komunës së Bogovinës**” (12:40, 11 korrik 2017, Almakos).
- “lajmëruar se zyrtarë të **komunës së Sarajit**” (17:52, 09 janar 2018, Almakos).
- “**Ministria e shëndetësisë** u shndërrua ministri e biznesit në katër sy” (22 shtator 2018, Lajmpress).

Të pyetur për problemin në fjalë, nga komuna e Bogovinës thonë se problemi qëndron tek ministria e arsimit ku ke kohë është dorëzuar kërkesa për rindërtimin e shkollës.

Fotografia nr. 2

Nga ana tjetër kryetari i komunës së Likovës, Erkan Arifi shpjegoi se problemi që ka penguar përgatitjen e hapjes së kufirit nga ana e Maqedonisë ka qenë mungesa e infrastrukturës, për të cilën, sipas tij, Qevria nuk ka mundur të investojë.

Ai tha se komuna e Likovës, me atë pak buxhet që ka, ka arritur që të rregullojë pjesën infrastrukturore dhe nga ana e Maqedonisë gjithçka është gati sa i përket pjesës infrastrukturore.

Politikologu Xhenis Sulimani tha se kryetarët e komunave duhet të jenë të kujdesshëm me premtimet kohore, meqë sipas tij, në bazë të përvojës së deritanishme në këto dy vende, afatet dinë të shtyhen me vite.

Fotografia nr.3

Këto janë vetëm disa emra të institucioneve, që janë përdorur më tepër në këto portale, por gjithsesi ka edhe emra të institucioneve të tjera që i gjejmë me shkronja të vogla.

### Gabime gramatikore, drejtshkrimore dhe teknike

Duke parë gabime të shumta teknike, përpara syve na dalin edhe një sërë gabimesh gramatikore dhe mospërputhje të fjalëve, gjë që vë në dukje papërgjegjësinë e shqipshkruesve dhe kontrollimin e tyre. Gabimet janë të shpeshta dhe gati në çdo lajm nëse analizojmë mirë e mirë mund të gjejmë gabime të llojeve të ndryshme duke filluar nga ato të mungesës së shkronjave “ë” dhe “ç”, mospërdorimi i shkronjës së madhe te emrat e përvetçëm, gabime teknike, gabime drejtshkrimore e gramatikore që i përmendëm më lartë.

Në shembullin e dhënë më poshtë që përbëhet vetëm nga pak fjalë hasim shumë gabime:

- “Disa qytetarë të Sarajit sot për Almakos **kamë** lajmëruar se zyrtarë të **komunës** së Sarajit, përmes kamionit që mbledh mbeturinat, ata hedhurinat i kanë gjuajtur në lumin Treska” (17:52, 09 janar 2018, Almakos).

P.sh.

- “sot për Almakos **kamë** lajmëruar” – në vend të foljes ndihmëse “**kanë**” (veta e tretë, numri shumë) është përdorur folja ndihmëse “**kamë**” (veta e parë, numri njëjës). Këtu hasim edhe një gabim gramatikor, për arsye se folja “**kam**” shënohet pa “ë” në fund.

P.sh. “*Unë kam*”, e jo “*Unë kamë*”.

- “zyrtarë të **komunë** së Sarajit” – kemi mungesë të shkronjës së madhe “**komunës** së Sarajit” (duke e ditur se emrat e përveçëm shënohen me shkronjë të madhe, tek emrat e përveçëm hyjnë edhe emrat e institucioneve).
- “**komunë** së Sarajit” në vend të Komunës së Sarajit (ku hasim gabim teknik në vend “*komunës*” – “*komunë*”, na mungon shkronja “s”).

Këto janë disa gabime të hasura vetëm në fillimin e lajmit dhe të tilla gjejmë shumë e më shumë nëse e analizojmë lajmin e plotë.

Nga kto hulumtime të pakta që janë bërë janë hasur një numër i madh i gabimeve dhe nëse vazhdojmë të hulumtojmë edhe më shumë me siguri do të gjejmë edhe shumë e me shumë gabime të llojeve të ndryshme.

#### Disa shembuj të tjerë nga gabimet teknike

- “Rreth orës 21.15, te shtunen **mbrena** qendra e thirrjeve emergjente kantonale në Aarau ka pranuar një alarm”; (24 shtator 2018, Lajmpress);
- “Qeveria **nuke** komenton letrën për Jugohromin” (9 korrik 2018, Lajmpress);
- “Drejtuesit e Bayernit nga Munichu, kampion aktual të **Gjermanisë**” (06 korrik 2018, Lajmpress);
- “**ë** se 200 nxënës të fshatit Novosellë të Bogovinës, vitin shkollor e kanë përfunduar jashtë objektit shkollor” (7 korrik 2018, Lajmpress);
- “Minaj ka bërë të ditur se ky nuk do të jetë videoklipi i vetëm i kësaj kënge, pasi këngëtarët do të sjellin edhe një video **muzikore tjetër muzikore** për “Bed”” (19:28, 08 korrik 2018, Almakos);
- “tha Reshat **Azizi.kryetar** i këshillit të prindërve të shkollës “11 tetori” (7 korrik 2018, Lajmpress);
- “Përgjegjës për arsim në **kom e Bogovinës**” (7 korrik 2018, Lajmpress);
- “*qoftë që jetojnë Kroacia apo vendet tjera*” (8 korrik 2018, Almakos).

Drejtuesit e Bayernit nga Munichu, kampion aktual të Gjermanisë, njoftuan se më nuk kanë bileta të lira në shitje për sezonin e ri. Bileta nuk ka as për tifozët mysafirë. Kapaciteti i Allianz Arenës është 75.000 shikues, por Bayerni është i obliguar të ruaj disa qindra bileta për në ditën e ndeshjes. Përveç ndeshjeve kampionale, билетat janë shitur edhe për ndeshjet e kupës.

*Fotografia nr. 4*

Ariana Grande në klipin e këngës “Bed” (Foto: YouTube/Nicki Minaj)

Minaj ka bërë të ditur se ky nuk do të jetë videoklipi i vetëm i kësaj kënge, pasi këngëtarët do të sjellin edhe një video muzikore tjetër muzikore për “Bed”.

Në ndërkohë, për më pak se 48 orë, videoklipi është shikuar afro shtatë milionë herë në YouTube. /Telegrafi/

*Fotografia nr. 5*

mbajt mësimin po ashtu edhe ca lokale private që janë shfrytëzuar që filmijet mos humbin vitin shkollor 2017/2018 ato nuk i kemi më në shërbim”, tha Reshat Azizi.kryetar i këshillit të prindërve të shkollës “11 tetori -tha Reshat Azizi.kryetar i këshillit të prindërve të shkollës “11 tetori”.

*Fotografia nr. 6*

"Që nga 17 nëntori i vitit të kaluar, ne gjitha dokumentacionet që na kanë kërkuar në Ministrinë e Arsimit i kemi kompletuar dhe i mbetet Ministrisë së Arsimit që të intervenojë, gjegjësisht të bëjë specifikacinin dhe të hap tenderin", deklaroi Nuriman Tefiku. Përgjegjës për arsim në kom e Bogovinës. /alsat-m/

Fotografia nr. 7

Fansat e Ritës (Foto: Instagram/RitaOra)

Krahas fansave të shumtë kroate dhe nga i gjithë rajoni, në koncert nuk kanë munguar edhe fansat shqiptarë, nga Kosova dhe Shqipëria, qoftë që jetojnë Kroacia apo vende të tjera.

Lexo po ashtu:

Ata e kanë marrë vëmendjen e Ritës duke ekspozuar flamurin kombëtar dhe flamurin e Kosovës, ndërsa këngëtarja është kujdesur për një përshëndetje të veçantë.

Fotografia nr. 8

"Ka punë të cilat duhet të saktësohen, por me rëndësi është se edhe opozita edhe pushteti presin dhe dëshirojnë që Komisioni i Venedikut të deklarohet për kompleksitetin e punës që këto ligje të jenë efikase dhe të dobishme në të ardhmen", deklaroi Dimitrov.

Përfaqësuesit e Komisionit të Venedikut dje u takuan edhe me ministrin e Drejtësisë Renata Deskoska. Mefail Ismaili /SHENJA/

Fotografia nr. 9

Përhapja e portaleve online dhe mos kontrollimi i tyre vjen si pasojë e gabimeve të shumta, të cilat nuk i kontrollojnë askush, as edhe që lektorohen para daljes publike dhe ashtu siç e shkruajnë gazetarët apo lajmdhënësit ashtu edhe publikohen. Nga këto jokontrollime hasim gabime masive, jo vetëm gabime teknike por edhe një numër të madh edhe të gabimeve drejtshkrimore.

### Përfundimi

Sa i përket këtij punimi del në pah moskujdesia e gjuhës dhe dëmtimi i saj, ky është një dëm i madh jo vetëm për gjuhën, por edhe për mbarë shoqërinë dhe vëmendja më e madhe duhet të jetë nëpër këto publikime apo lajme për arsye se leximi i rëndomtë gati ka humbur peshën dhe pjesa dërmuese lexojnë online, kështu që nëpër këto portale online duhet të kemi kujdes në drejtshkrim që lexuesit gjatë leximit të mësojnë diçka që nuk dinë për gjuhën dhe drejtshkrimin e saj, e jo ta humbin atë që e dinë, e të mbeten në dilemë:

"E di apo e kam gabim?". (P.sh. "komuna e Tetovës", shkruhet me shkronjë të madhe apo të vogël). Gjuhën duhet ta shkruajmë bukur dhe pastër ashtu siç është, e jo ta dëmtojmë atë dhe mbarë shoqërinë që lexon, por lexuesit duke i dhënë informacion dhe lajm t'ja pasurojmë edhe gjuhën.

### Bibliografia

Bejta, Murat (redaktor). (1988). *Fjalor i fjalëve të huaja*. Rilindja. Prishtinë.  
Grup autorësh. (Hamiti, Sabri, Shala, Kujtim, Idrizi, Xhemaludin, Aliu, Ali & Metani, Idriz), (2009). *Gjuha shqipe dhe letërsia 1*. (Për gjimnazet e reformuara). Albas. Tiranë, Prishtinë, Tetovë.  
"Drejtshkrimi i gjuhës shqipe", Instituti Albanologjik, 1974, Prishtinë.  
(<http://www.drejtshkrimi.info/shemadhe>).  
<http://lajmpress.org/>  
<https://www.almakos.com/>